



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 44
Prishtinë, më 09.07.2019
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Albert Kinolli, Emilija Rexhepi, Mërgim Lushtaku, Avdullah Hoti, Valon Ramadani dhe Ali Lajçi.

Munguan: Andin Hoti, Verica Qeraniç, Faton Topalli dhe Etem Arifi.

Stafi mbështetës: Mehmet Simnica, Antigona Ibraj, Ajet Avdullahu, Flakë Hajdini dhe Sara Idrizi.

I ftuar: Përfaqësuesit e NP Kompania Rajonale e Ujitjes “Drini i Bardhë” Galdim Krasniqi dhe Bedri Haxhijaj. Përfaqësuesit e KRU “Hidroregjioni Jugor” SH. A. Prizreni, Rexhep Manxhuka, Besim Baraliu, Ibrahim Bajraktari dhe Ymridin Sylejmani.

Pjesëmarrësit tjerë: Arbër Rexhaj deputet, Ganimete Dalloshi, Fitim Haliti, Arvita Zylferi, Liridona Berisha, Violeta Smajlaj, Enver Boqolli nga ZKA, Blerta Bejtullahu dhe Marigona Berisha.

Rendi i Ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 04.07.2019;**
- 3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Ujitjes “Drini i Bardhë” SH. A. për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018;**
- 4. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për PVF-të e KRU “Hidroregjioni Jugor” SH. A. Prizren për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018;**
- 5. Të ndryshme.**

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime (u vendos që procesverballi të miratohet në mbledhjen e ardhshme për arsyeje se deputetët nuk kanë arritur ta lexojnë).

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 04.07.2019

Procesverballi i mbledhjes, të mbajtur më 04.07.2019, nuk u miratua nga ana e deputetëve, pasi që procesverballi për shkak të kohës shumë të shkurtër për ta përpiluar, lekturuar dhe përkthyer u arrit tu dorëzohet anëtareve të komisionit pak para fillimit të mbledhjes më 09/07/2019.

3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Ujitjes “Drini i Bardhë” SH. A. për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018

Mërgim Lushtaku përshëndet të pranishmit dhe filloi me një përmbledhje të shkurtër me çështjet më të rëndësishme që kanë dalë nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Kompanisë Rajonale të Ujitjes “Drini i Bardhë” SH. A. për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018.

Raport ka të bëjë me auditimin e rregullsisë, i cili është i obligueshëm me ligj, dhe përmbledh çështjet e dala nga auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të Kompanisë Regjionale të Ujitjes “Drini i Bardhë” SH.A. (KRU “Drini i Bardhë”). Qëllimi primar i auditimit ishte dhënia e opinionit, nëse PVF-të kanë prezantuar një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Përveç kësaj janë shikuar edhe disa aspekte të qeverisjes dhe pajtueshmërinë e transaksioneve me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme.

Janë audituar PFV-të e KRU Drini i Bardhë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhjes së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, si dhe përmbledhjen e procedurave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese. Ekzaminimi i pasqyrave financiare është ndërmarrë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA).

Për shkak të mungesës së dëshmive të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, ZKA nuk ka qenë në gjendje të japë opinion për PFV-të e vitit 2018.

Çështjet të cilat kanë ndikuar në mohim të opinionit janë:

- Pasuritë e Kompanisë të prezantuara në pasqyrën e pozitës financiare nuk janë të barabarta me detyrimet dhe kapitalin për shumën 82,650€. Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesës së regjistrave të saktë të zërave financiar të cilët rrjedhimisht shkaktojnë mos balancë të pasqyrës së pozicionit financiar.
- Menaxhmenti i kompanisë nuk ka arritur të dëshmojë se kur ka ndodhur për herë të fundit procesi i vlerësimit të asetëve që janë në pronësi ose menaxhim të kompanisë. Si rrjedhojë, vlera e tokës e regjistruar në librat kontabël është 924,200€, ndërsa vlera e ndërtesave 513,393€. Kompania nuk ka arritur të na ofrojë ndonjë dokument zyrtar që dëshmon vlerën e këtyre pronave.
- Në regjistrat kontabël asetet ishin të regjistruara vetëm si saldo e vitit 2017 në vlerë 3,737,885€. Përveç një raporti përmbledhës të formatit excel në të cilin janë të regjistruara asetet e kompanisë deri në fund të vitit 2017, kompania nuk kishte shënime analitike nga ndonjë modul i veçantë i kontabilitetit për menaxhim të asetëve i cili do të ishte bazë për konfirmimin e saktësisë së vlerës së prezantuar. Përveç kësaj, vlera në regjistrin kontabël (saldo e vitit 2017) ishte për 48,250€ më e lartë se vlera e tyre e prezantuar në raportin e pasurive në excel.

- Kompania në shënimet shpjeguese kishte prezantuar se aplikon metodën lineare (drejtvizore) për zhvlerësimin e asetëve. Ndërsa testimet e ZKA-së tregojnë se kompania me rastin e zhvlerësimit të asetëve kishte aplikuar metodën e zvogëlimit të tepicës dhe kjo ka rezultuar me shpenzime me të ulëta të zhvlerësimit në vlerë 198,614€ për dallim nga shpenzimet që do të duhej të prezantoheshin nëse do të aplikoheshin metoda lineare, siç është prezantuar në shënimet shpjeguese.
- Kompania nuk kishte bërë harmonizimin në mes të regjistrit të asetëve dhe raportit të komisionit për inventarizim, të dorëzuar në fund të vitit 2018. Si pasojë e kësaj është vërejtur mospërputhje në mes regjistrit të asetëve (excel) me raportet e inventarizimit si vijon:

- Në raportin e asetëve (excel) figurojnë katër asete (kanale të ujitjes) të cilat nuk janë të prezantuara në raportet e inventarizimit. Vlera e këtyre asetëve në fund të vitit 2017 ishte 342,082€;

- Katër asete (kanale të ujitjes) në vlerë 68,866€ të prezantuara në regjistrin e asetëve, sipas komisionit të inventarizimit nuk janë nën menaxhimin e kompanisë.

- Ndërsa, 34 asete (kanale dhe penda) të cilat janë të prezantuara në raportin e inventarizimit nuk figurojnë në regjistrin e asetëve, për të cilat ne nuk ishim në gjendje të përfitojmë evidenca lidhur me plotësinë dhe saktësinë e asetëve dhe si rrjedhojë e kësaj dhe zhvlerësimin e tyre.

- Kompania nuk kishte zbatuar kërkesat e standardeve për zhvlerësim të asetëve që nga momenti kur aseti është në përdorim. Kjo sepse, tri asete në vlerë 383,322€ të cilat sipas raporteve të pranimeve teknike ishin funksionalizuar në fund të vitit 2017 respektivisht në fund të vitit 2018 i kishte njohur si investime në vijim. Regjistrimet e tilla kanë rezultuar me nënvlerësim të shpenzimeve të zhvlerësimit për 5,940€ dhe mbivlerësim të asetëve.

- Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në pasqyra financiare për vitin 2018 ishin 53,661€, ndërsa për vitin 2017 kompania kishte njohur 48,960€ si shpenzime për borxhe të këqija. Menaxhmenti i kompanisë nuk ishte në gjendje të na ofrojë evidenca lidhur me llogaritë të cilat i ka njohur si borxhe të këqija, dhe për shkak të këtij efekti ne nuk jemi në gjendje të vërtetojmë saktësinë e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit.

- Kompania gjatë vitit 2018 kishte prezantuar TVSH-në e pagueshme në shumën totale 16,485€, ndërsa TVSH-në e zbritshme 32,658€, që rezulton me një saldo debitore 16,173€. Mirëpo, analizat tona të bëra bazuar në deklaratat tatimore për këtë llogari tatimore dhe gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera të tatim paguesit, rezulton se kompania ka saldo debitore për TVSH-në për vitin 2018 në vlerë prej 24,835€.

Ndërsa sa i përket rekomandimeve nga viti paraprak i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të KRU Drini i Bardhë ka rezultuar me mohim të opinionit dhe ishin dhënë 20 rekomandime kryesore.

Kompania kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Vërehet angazhim në adresimin e çështjeve dhe rekomandimeve të dala në raportin e kaluar të auditimit dhe deri në fund të auditimit, për vitin 2018, zbatimi i rekomandimeve ishte si vijon: 9 rekomandime janë zbatuar; 4 ishin në proces dhe 7 nuk janë adresuar ende.

Galdim Krasniqi (kryesues i bordit KRU "Drini i Bardhë")—Kryesuesi i bordit është i sapo emëruar dhe nuk ka informacione shumë të sakta për kompaninë, por e ka lexuar raportin e auditimit dhe mendon se duhet të punohet në drejtimin e përmirësimit të situatës.

Bedri Hxhijaj (kryeshefi Ekzekutiv): Kryeshefi Ekzekutiv e ushtron këtë post që nga 2016. KRU Drini i Bardhë ka përpiluar një plan veprimi për vitin e kaluar dhe janë përkushtuar për t'eliminuar të gjeturat e auditorit, mirëpo në momentin kur është hartuar plani për eliminimin e të gjeturave ZKF-ja, si kryetare e komisionit, ka shkuar në pushim të lehonisë. Është menduar edhe opsioni për angazhimin e një eksperti të jashtëm të kontabilitetit pasi që me stafin aktual është pothuajse e pamundur të bëhet eliminimi i të gjeturave. Kryeshefi Ekzekutiv zotohet që me bordin e ri të sapo emëruar dhe me ndihmën e ndonjë eksperti të jashtëm, t'i eliminojnë të gjeturat.

Avdullah Hoti: Komisioni zakonisht diskuton për të gjeturat e raportit të auditorit, çfarë natyre kanë dhe se si mund të adresohen të gjeturat, por në këtë rast raporti nuk ka opinion dhe auditori shpreh se në bazë të pasqyrave vjetore nuk mund të vërtetohet apo konkludohet asgjë në parim me standardet e kontabilitetit. Ky raport është skandaloz dhe nxjerr në pah faktin se kjo kompani nuk është duke u menaxhuar, fare. Në këtë rast z. Hoti mendon se komisioni nuk ka se çfarë të diskutojë bazuar në mungesën të dëshmive dhe shifrave jo kredibile. Diskutimi me KRU "Drini i Bardhë" duhet të përmbillet dhe diskutimi të vazhdohet vetëm përbrenda anëtarëve të komisionit, se çfarë rekomandime duhet nxjerrë për aksionarin e kësaj kompanie, Qeverinë e Kosovës. Që nga viti 2016 e tutje askush nuk e ka penguar kryeshefin Ekzekutiv të angazhojë personat e duhur për t'i rregulluar pasqyrat financiare dhe për ta rritur inkasimin, i cili ka shënuar rënje për rreth 20-30%. Z. Hoti propozoi që diskutimi duhet të përmbillet pa asnjë arsyetim shtesë nga KRU "Drini i Bardhë".

Bedri Haxhijaj (kryeshefi ekzekutiv): KRU "Drini i Bardhë" ka një sistem mjaft primitiv, sa i përket inkasimit prej vitit 2016 deri më 2017 është rritur dukshëm inkasomi, ndërsa për vitin 2018 mungesa e stafit dhe mjeteve për zgjerimin e stafit ka rezultuar në këtë situatë. Kompani ka një plan biznesi prej 150,000€ në baza vjetore.

Kryetari mendon se ka një kontradiktë në atë që e tha kryeshefi Ekzekutiv the se kompania ka shkelur edhe procedurat për rekrutimin për ZKF për faktin se ka pasur rast kur aplikuesi edhe pse i ka përmbushur kriteret nuk është ftuar në intervistë dhe janë shkelur udhëzimet administrative të rekrutimit.

Bedri Haxhijaj (kryeshefi Ekzekutiv): Bordi është përgjegjës për përzgjedhjen e zyrtarëve të lartë dhe kryeshefi Ekzekutiv nuk ka kompetenca për përzgjedhje.

Avdullah Hoti përshkruan situatën aktuale, duke theksuar se Qeveria e Kosovës si aksionare kryesore, e mbikëqyrur nga KMFP bazuar në raportet e auditorit, nuk ka një ide të qartë se si po menaxhohen asetet prandaj diskutimi duhet të ndërpritet.

Kryetari pajtohet me z. Hoti për ta përmbjllur diskutimin me kaq, dhe mendon se kjo çështje duhet të diskutohet në nivel të seancës plenare, por edhe nga organet tjera, të cilat merren me trajtimin e çështjeve në fushën e menaxhimit të financave publike.

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që raporti i auditimit për PVF-të e KRU "Drini i Bardhë" për vitin e përfunduar 2018 të adresohet për në Seancë Plenare, së bashku me rekomandimet e komisionit funksional. Po ashtu komisioni vendosi t'i rekomandojë Qeverisë së Kosovës marrjen nën administrim të Ndërmarrjes Publike KRU "Drini i Bardhë".

4. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për PVF-të e KRU "Hidroregjioni Jugor" SH. A. Prizren për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018

Kryetari: Deputet raportues për raportin e auditimit për PVF-të e KRU Hidrogjeni Jugor për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018 është deputeti Avdullah Hoti.

Avdullah Hoti përshëndet përfaqësuesit e kompanisë "Hidroregjioni Jugor" duke sqaruar se kompania është vlerësuar me opinion të kundërt, kjo nënkupton se përkundër dëshmime që i janë ofruar ZKA-së nuk është mundur të konkludohet asgjë për rregullsinë dhe vërtetësinë e atyre shifrave. Në terma më të thjeshtë kjo nënkupton që aksionari i aseteve, të cilat janë duke u menaxhuar nga kompania në fjalë nuk ka asnjë informatë se si po menaxhohen këto asete, dhe se shifrat e paraqitura nuk kanë asnjë përputhje me standardet e kontabilitetit. Kryesuesi i bordit nuk është dakorduar me disa prej të gjeturave nga ZKA-ja, por as nuk ka dhënë arsyeje me fakte për t'i demantuar të gjeturat. Z. Hoti mendon se diskutimi duhet të ndërpritet si në rastin e kompanisë paraprake për faktin se asnjë shifër e prezantuar nuk konsiderohet si e mirëqenë dhe e vërtetë.

Kryetari thekson se opinioni i ZKA-së është ndër më të këqijtë, opinion i kundërt, si më i keqi në hierarkinë e opinionëve dhe se nëse vazhdohet diskutimi mund të devalvohet opinioni objektiv i ZKA-së. Por duhet të dëgjohet edhe vlerësimi i kompanisë nga perspektiva e tyre.

Rexhep Manxhuka: Auditimi është një praktikë e mirë e vlerësimit të probleme dhe ofron mundësinë e mos përsëritjes së të gjeturave të njëjta në vitet e ardhshme. Si në rastin e vitit të kaluar, por edhe tash si bazë e opinionit të kundërt ka qenë mos rivlerësimi i aseteve që nga viti 2007, kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mungesës së një komisioni adekuat për vlerësimin e aseteve. Z. Manxhuka shpreh gatishmërinë e tij për të punuar në drejtim të adresimit të rekomandimeve. Sa i përket të gjeturës për mosrespektimin e proceduarve të prokurimit, në ndërmarrjet publike shërbyese është sfidë të parashikohen dhe të planifikohen të gjitha rastet, sidomos rasteve që kanë periudha të shkurtra kohore për veprim. Nga 13 rekomandime nga viti i kaluar, kompania nuk ka arritur t'i adresoj vetëm katër prej tyre.

Kryetari potencoi faktin se raporti për vitin e përfunduar 2018 është më keq se raporti i vitit paraprak kjo tregon se nuk ka përmirësim të situatës.

Besim Baraliu (kryeshef Ekzekutiv) nuk pajtohet plotësisht me të gjeturat pasi mendon se gjendja reale është më mirë nga ajo se çka është paraqitur në raport. Sa i përket vlerësimit të aseve kompania është munduar të punojë në këtë drejtim por përgjegjësia për dështimin e këtij procesit duhet t'i takojë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, ministri e cila e morri përsipër këtë detyrë. Ndërsa për të gjeturat tjera zyrtarët financiarë janë më kompetent për t'i sqaruar, e jo unë si kryeshef Ekzekutiv.

Avdullah Hoti pasi që dëgjoi arsyetimet nga përfaqësuesit e KRU "Hidroregjioni Jugor" vendosi t'i shpalos disa detaje siç janë performanca e kompanisë në humbjet e ujit, e cila ka shënuar një rënie prej vetëm 1% nga 58% në 57% më pas auditori nuk ka mundur të gjej asnjë evidencë të besueshme as për të hyrat e as edhe për shpenzimet, gjë e cila potencohet te e gjetura për pranimet e pagesave nga klientë të pidentifikuar si rezultat i gjithë kësaj nuk mund të

rregullohet as çështja e inkasimit pasi nuk dihet se kush janë konsumatorët apo shuma e mjeteve të paguara e cila nuk dihet se nga vije, ndërsa në anën tjetër konsumatorëve nuk ju zbriten borxhet. Te rasti i shpenzimeve nuk janë respektuar procedurat e prokurimit, ku nuk duhet të merret parasysh shuma sado e vogël që të jetë, por të respektohet ligji. Kompania nuk ka ofruar evidencë as për performancë e as për të hyrat dhe shpenzimet. Si aksionar shteti i Kosovës i ka besuar kësaj kompanie një aset, i cili nuk është duke u menaxhuar aspak siç do duhej të ishte.

Arbër Rexhaj (deputet i interesuar) theksoi disa detaje nga të gjeturat e raportit që lidhen me anashkalimin e procedurave të prokurimit që sipas përfaqësuesve të kompanisë kanë ndodhur për shkak të limit kohor dhe vëllimit të madh të punëve. Nëntëdhjetë pagesa me tre operatorë ekonomik të ndryshëm për shpenzime të mirëmbajtjes së automjeteve vlera e përgjithshme e të cila arrijnë 5,735€. Z. Rexha e ka të pa qartë se si nuk është respektuar procedura e prokurimit në pagesën e pesë biletave për aeroplan prej 1,375€, në rastin e njëzet e dy pagesave për mjete higjienike prej 470€, katërbëdhjetë pagesave tjera prej 1,372€ për mjete dhe njëzet pagesa për furnizim me pjesë prej 1,181€.

Kryetari potencoi se përfundimet e ZKA-së merren si të mirëqena nga komisioni dhe nuk duhet kontestuar. Kryetari mendon se duhet mbyllur trajtimi i këtij raporti nga ana e komisionit dhe se raport të trajtohet në nivel të seancës plenare ashtu si dhe raporti i kompanisë paraprake.

Avdullah Hoti propozoi që komisioni të nxjerrë një rekomandim drejtuar Qeverisë e më pas seancës, që këto dy kompani, bazuar në ligjin për ndërmarrje publike, të merren nën administrimin e drejtpërdrejtë të Qeverisë.

Valon Ramadani pajtohet se komisioni duhet të dalë me disa rekomandime si për seancën ashtu edhe për Qeverinë dhe Prokurorinë.

Mërgim Lushtaku mendon se nuk duhet të nxitojnë sa i përket rekomandimit që kompanitë të kalojnë nën administrimin e Qeverisë, pasi që duhet një kohë me e gjatë në mënyrë që konsultohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, komiteti ndërministror, si dhe ligji për ndërmarrjet publike. Dhe përsëriti se për këtë nuk do të votojë këtë përfundim

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që raporti i auditimit për PVF-të e KRU "Hidroregjioni Jugor" për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 të adresohet për në Seancë Plenare, së bashku me rekomandimet e komisionit funksional. Po ashtu komisioni vendosi t'i rekomandojë Qeverisë së Kosovës marrjen nën administrim të KRU "Hidroregjioni Jugor" me gjashtë vota për dhe një abstenim nga z. Mërgim Lushtaku.

5. Të ndryshme.

Kryetari njoftoi deputetët se për mbledhjen e radhës të komisionit për të martën 16/07/2019 planifikohet të shqyrtohen tre raporte: Shqyrtimi i raportit të Auditimit të Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Ujitjes “Prishtina“ sh. A. për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018 (Raportues Valon Ramadani); shqyrtimi i raportit të Auditimit për PVF-të e Postës së Kosovës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018 (Raportues Driton Selmanaj) dhe shqyrtimi i raportit të Auditimit për PVF-të e Telekomit të Kosovës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018 (Raportues Albert Kinolli).

Mbledhja përfundoi në 12.30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj